

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Mentorimi dhe vlerësimi i performancës</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi i lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I-rë (semestri i dytë)</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>7</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E enjtë, 16:00-18:15, Salla P4</b>
<b>Mësimdhënëset e lëndës:</b>	<b>Linda Salihu, Ligjëruese</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:linda.salihu@uni-pr.edu">linda.salihu@uni-pr.edu</a> zyra 4</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Ekziston një mungesë e dukshme e profesionistëve shkollorë të përgatitur për t'u bërë akterë kompetentë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollë. Sfida e reformimit të arsimit në vend krijon nevojën për profesionistë të dijshtëm dhe të shkathhtë, të gatshëm për të hyrë në veprim. Presioni institucional shkollor dhe ai shoqëror, fëmijëria dhe periudha e adoleshencës e bëjnë të nevojshëm mentorimin e mësimdhënësve të cilët kanë nevojë për ndihmesë shtesë nga një udhërrëfyes i kujdesshëm profesional që është në shërbim të tyre. Rrjedhimisht, monitorimi dhe vlerësimi sistematik i performancës së mësimdhënësve bëhen pjesë të pandara të procesit të reformës. Lënda ju ofron studentëve aspektet teorike dhe praktike të këtyre çështjeve me qëllim të përbaljes me nevojat në rritje të mësimdhënësve për zhvillim profesional, duke u dhënë udhëzime për intervenim efektiv në përparimin e të gjithë nxënësve në shkollë. Si e tillë lënda ju jep studentëve mjetet e nevojshme për adresimin e shqetësimeve të mësimdhënësve, prindërve, profesionistëve të tjerë në shkollë dhe komunitetit për t'u përballur në mënyrë më efektive me sfidat dhe çështjet komplekse të fëmijëve dhe adoleshentëve të sotëm.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është t'u ofrojë qasje studentëve në njohuritë dhe shkathhtësitë lidhur me mentorimin, monitorimin dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënësve që së bashku bëjnë të mundur çuarjen përpara të përmirësimit të praktikave mësimore në shkollë.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Me përfundimin e lëndës pritet që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë parimet dhe standardet themelore të procesit të mentorimit dhe të monitorimit e vlerësimit të performancës;</li> <li>- Hartojnë një plan me udhëzime praktike të</li> </ul>

	<p>planifikuara për mësimdhënësin lidhur me një çështje konkrete (p.sh. nga fusha mësimore, sociale apo personale që mund të ketë ndikim te fëmija apo adoleshenti);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raportojnë për një aktivitet që tregon asistimin në të ndihmuarit e mësimdhënësit për të arritur një qëllim mësimor për nxënësit e caktuar që kërkojnë vëmendje të veçantë si dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të arritjes së qëllimit në fjalë.</li> <li>- Vlerësojnë sfidat dhe mundësitë për ofrimin e mentorimit dhe vlerësimit në institucionet arsimore dhe edukative të Kosovës.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënësit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Kollokfiime, seminare	2	4	8
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	6	3	18
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj	2	5	10
<b>Totali</b>	<b>26</b>	<b>75</b>	<b>180</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Përmbajtja e kësaj lënde do të prezantohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla, në çifte dhe në punë individuale. Studentët do të jenë të angazhuar në diskutime interaktive të cilat planifikohen për reflektim dhe zbatim të pjesëve të caktuara të leximit e studimit duke i kombinuar ato me përvojat e fituara gjatë praktikës në terren.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi i rregullt në orët e mësimi	10 pikë	
	Pjesëmarrja aktive në mësim	20 pikë	
	Kollokviumi	20 pikë	
	Provimi përfundimtar	50 pikë	
	<b>Gjithsej:</b>	100 pikë	
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Darling-Hammond, L. (2013). Getting teacher evaluation right: What really matters for effectiveness and improvement. New York, NY: Teachers College Press.		

	<p>Waring, M., &amp; Evans, C. (2015). Understanding pedagogy: Developing a critical approach to teaching and learning. London: Routledge.</p> <p>Hargreaves, A., &amp; Fullan, M. (2012). Professional capital: Transforming teaching in every school. London and New York: Routledge.</p> <p>Danielson, C. (2007). Enhancing professional practice: A framework for teaching. Alexandria, VA: ASCD.</p> <p>Garo, S. (2011). Metodologjia dhe praktika e mësimdhënies: Mësimnxënia, instruktimi, vlerësimi i mësimdhënies, menaxhimi i klasës. Tiranë: U.F.O. Press.</p> <p>Salihu, L., Aro, M., &amp; Räsänen, P. (2018). Children with learning difficulties in mathematics: Relating mathematics skills and reading comprehension. <i>Issues in Educational Research</i>, 28(4), 1024-1038.</p> <p>UNESCO. (2015). Education for all 2000-2015: Achievement and challenges. EFA Global Monitoring Report. Paris: UNESCO.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë Nr.2004/37; Udhëzimi Administrativ Nr.14/2018 për Vlerësimin e Mësimdhënësve si dhe dokumente të tjera të hartuara nga MASHT.</p> <p>BEP. (2016). Puna e pedagogut të shkollës. Vëllimi II. Prishtinë: Basic Education Program/USAID.</p> <p>Salihu, L., Aro, M., &amp; Räsänen, P. (2017). Zhvillimi i shkathtësive për matematikë dhe lexim te nxënësit me vështirësi në të nxënët e matematikës. Kumtesat nga Konferenca Vjetore e Shkencës 'Java e Shkencës' 2016 (fq. 365-371). Prishtinë: MASHT.</p> <p>Westwood, P. (2008). What teachers need to know about learning difficulties. Camberwell, Vic.: ACER Press.</p> <p>Price, K. M., &amp; Karna, N. L. (2010). Planning effective instruction: Diversity, responsive methods and management. Wadsworth Publishing.</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Përmbajtjet e procesit të mentorimit dhe të vlerësimit të performancës

<b>Java e dytë:</b>	Standardet për mentorim, monitorim dhe vlerësim të drejtë dhe efektiv
<b>Java e tretë:</b>	Mentorimi në lëmin e planifikimit dhe të përgatitjes së procesit edukativ në institucionet edukativo-arsimore
<b>Java e katërt:</b>	Mentorimi në çështje të drejtperdrejta të organizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies
<b>Java e pestë:</b>	Monitorimi dhe vlerësimi i organizimit të mësimit dhe të formave komplementare jashtë mësimit
<b>Java e gjashtë:</b>	Mentorimi në çështje të vlerësimit të arritshmërisë së nxënësve dhe në interpretim të rezultateve bazuar në kurrikulë
<b>Java e shtatë:</b>	Sajimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i dokumentacionit pedagogjik në shërbim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
<b>Java e tetë:</b>	Kollokviumi
<b>Java e nëntë:</b>	Mentorimi në çështje të vlerësimit dhe të trajtimit të fëmijëve dhe adoleshentëve me vështirësi në të nxënë
<b>Java e dhjetë:</b>	Identifikimi dhe trajtimi i fëmijëve dhe adoleshentëve me sjellje të paparanueshme sociale
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Mentorimi në çështje të identifikimit dhe trajtimit të fëmijëve dhe adoleshentëve të talentuar
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Prezantimi i punimeve të studentëve
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Vendosja e bashkëpunimit të drejtë me prindërit, komunitetin dhe profesionistët e tjerë në shkollë
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Bashkëveprimi cilësor shkollë, familje dhe komunitet në funksion të parandalimit të dukurive negative dhe të promovimit të vlerave individuale dhe kolektive
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Vështrim retrospektiv në çështjet kryesore të elaboruara; udhëzime për provimin përfundimtar

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes**

- Ardhja me kohë në orët e mësimit;
- Secilit student i lejohet që të parashtojë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala;
- Studentit nuk i lejohet t'i ndërhyjë tjetrit kur ai apo ajo e ka fjalën;
- Ndalohet përdorimi i telefonave celularë për çështje private.